

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.(B.) D. nga fshati B., Komuna e P., për shkak të veprave penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.380-4/2011 e dt.07.02.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik me datë 22.12.2015, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Gjejrone Alaj dhe të akuzuarit, me datë 23.12.2015 në prezencën e të akuzuarit dhe në mungesë të dëmtuarve mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 21.01.2016, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari,

**A.D.**, i biri i B. dhe nënës A., e vajzërisë H., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin B., KK P., ku edhe tani jeton, me nr. personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i dy fëmijëve, më parë i gjykuar për veprë të njëjtë, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej datës **25.01.2011 deri më dt.08.02.2011**.

Në bazë të nenit 363 par.1 pika1.3 të KPPRK-së,

### REFUZOHET AKUZA

**I.Me** qëllim që t'i sjell vetes përfitim pasuror të kundërligjshëm me paraqitjen e fakteve të rreme dhe fshehjen e fakteve të vërteta, me dt.13.08.2009, rreth orës 13:15, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin A.P., duke ia marrë shumën e të hollave prej 90€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë se jam shok i djemve tu në Angli dhe dua që ta kryej një punë dhe menjëherë ti kthej të hollat, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthye, i njëjti është identifikue nga ana e të dëmtuarit,-

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle për këtë veprë penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

## **L I R O H E T   N G A   A K U Z A**

**I.** Më dt.17.08.2010, rreth orës 13:00, në Podujevë, në parkun e qytetit, ka vënë në lajthim të dëmtuarin A.A., duke ia marrë shumën e të hollave prej 60€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë se jam miku yt dhe a ke të holla dua të blej diçka nga ushqimi, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

**II.** Më dt.24.05.2010, rreth orës 12:00, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin I. E., duke ia marrë shumën e të hollave prej 200€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se jam mik familjar dhe a ki të holla se po dua që ti thej disa Franga, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

**III.** Më dt.23.09.2010, rreth orës 13:40, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin S.D., duke ia marrë shumën e të hollave prej 255€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se dua që ti thej disa Franga, të kam mik dhe eja të ulemi pak se moti nuk të kam pa, duke ia kërkuar fillimisht 60€ dhe në momentin që i dëmtuari e hap badifoken e parave i njëjti vet ia merr 225€, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

**IV.** Më dt.22.12.2010, rreth orës 15:30, në Podujevë, afër NLB Bank, ka vënë në lajthim të dëmtuarin Xh.O., duke ia marrë shumën e të hollave prej 40€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se jam mik i yti dhe mi jep të hollat derisa ti thej të hollat, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

**V.** Më dt.22.12.2010, rreth orës 15:30, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin Xh. B., duke ia marrë shumën e të hollave prej 100€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se jam mik i yti dhe mi jep 100€ se menjëherë ti kthej porsa ti thej devizat, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

**VI.** Më dt.23.01.2011, rreth orës 11:00, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin I. S., dhe ia marrë shumën e të hollave prej 30€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se jam mik i yti dhe po dua me ti falë 50€, por mi jep ti 30€ pasi që unë i kam vetëm

100€, ashtu që pasi i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, por të njëjtin e ka vërejtur dëshmitarja L. H.,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle për këto vepra penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse,

I. Më dt.26.11.2010, rreth orës 14:30, në Podujevë, në rrugën "...", ka vënë në lajthim të dëmtuarin Y. E., duke ia marrë shumën e të hollave prej 50€, në atë mënyrë që të njëjtit ia ka treguar të pavërtetën duke i thënë; se jam mik i yti dhe mi jep 100€ se menjëherë ti kthej posa ti thej devizat, por pasi që i ka marrë të hollat ikë nga vendi duke mos u kthyer, i njëjti është identifikuar nga ana e të dëmtuarit,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3,11,15,34,36,38,60,64,73, 261, të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365,370,450,453,463, të KPPPK-së ,e

## **G J Y K O N**

Të akuzuarin A.(B.) D., me dënim me burg, ashtu që i shqipton **dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve**, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 73 par. 1 të KPK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, prej datës **25.01.2011 deri më datën 08.02.2011.**

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguaj shumën **prej 100 € (njëqind euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që t'ia kompensoj të dëmtuarit Y. (H.)E. nga fshati G. Komuna e P., shumën prej **50 €(pesëdhjetë euro)**.

Të dëmtuarit: A. (S.) P. nga P. rruga "...", dhe Xh. (J.) B., nga P. rruga "...", nr.... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur propozim akuzën me kërkesë për dhënien e Urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit

gjyqësor, PP.nr.380-4/2011 e dt.07.02.2011, kundër të akuzuarit A.D. nga fshati B., Komuna e P., për shkak veprave penale Mashtrimi nga neni 261 par.1 të KPK-së.

Gjykata me datë 05.02.2014, ka lëshuar aktgjykim-Urdhër Ndëshkimor, kundër të cilit i akuzuari brenda afatit ligjor ka parashtruar kundërshtim me arsyetimin se nuk i ka kryer këto vepra penale.

Pas leximit të aktakuzës i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprat penale për të cilat akuzohet.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetem pranë propozim akuzës dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, si dhe ta obligoj që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi, se e ndjen veten të pa fajshëm duke shtuar se nuk është e vërtetë se i kam kryer këto vepra penale, dhe kërkoj nga gjykata që ta shpall të pa fajshëm dhe ta liroj nga këto akuza.

Gjykata për veprën e parë si në dispozitivin nën I të aktgjykimit, ka konstatuar se ka arritur parashkrim absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale për të cilat është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri vjet, ligjvënësi ka përcaktuar në kuptim të nenit 90 par.1 nën par. 5 të KPK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3(tri) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim, ndërsa në dispozitën e nenit 91 par 6 të KPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale). Meqenëse nga koha e dyshimit të bazuar të kryerjes së veprës penale e 13.08.2009, e gjerë me marrjen e këtij aktgjykimi kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vite, ashtu që parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale ka arritur me datë 13.08.2015, prandaj gjykata vendosi me aktgjykim refuzues në bazë të nenit 363 par.1 pika1.3 të KPPRK-së.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët Y. E., A.A., Xh. B., dhe dëshmitaren zyrtaren policore L. H., të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike për veprën penale për të cilën i akuzuari u shpall fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit Y. E. dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar, veç tjerash ka deklaruar: Me datë 26.10.2011 isha në Podujevë te D. rruga “...” u takova me një person më tha se a po me njeh? Unë ju përgjigja jo ,më pyeti se për çka je dal? unë i tregova se kam dal ti marr do krune për bagëti. I njëjti më tha se unë e kam kerrin dhe të dërgoj deri në shtëpi dhe në atë moment i kisha disa para në dorë, më tha ami 50 euro derisa ti thej të hollat e mia, ja dhashë me dorën time dhe i njëjti person iku. Deklaroj me përgjegjësi se ky person është i cili mi ka marr paratë, dhe ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

I dëmtuari-dëshmitarit A.A., në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Më kujtohet se ka qenë data 17 dhe isha duke ecur qytetit ,më ka dal një person dhe më ka shmangur dhe me tha hajde ulemi dhe unë i kisha pasur në dorë 100 euro, më thojke se nuk kam para të imta dhe mi kërkoi 20 euro dhe mandej ma kapi kuletën prej dore dhe i kisha edhe 40 euro në kuletë mi mori të gjitha dhe iku. Unë e lajmërova menjëherë policinë dhe nuk më kujtohet saktësisht dhe nuk muj me than se është ky person.

I dëmtuari-dëshmitarit Xh. B. në shqyrtimin gjyqësor, veç tjerash ka deklaruar: Se më kujtohet që dikush mi ka marr 80 euro, ky person nuk është që mi ka marr të hollat, mirëpo ky person ka qenë para një viti e gjysmë te shtëpia dhe më tha se jam i akuzuar se të kam mashtruar dhe më pyeti se a po më njeh mua dhe unë i thash “vallahin nuk po të njoh” ky person i cili është në sallë nuk është ajë që më ka mashtruar.

Dëshmitarja zyrtarja policore L. H. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Me datë 23.01.2011 diku rreth orës 13:00 kam qenë në orar të punës në qytet në sheshin “...” dhe duke kaluar afër zyrës së avokatit H.P. e kam parë A.D. me një plak të moshës afër të 70-av,kur kam kaluar pranë tyre kam dëgjuar bisedën duke i thënë i moshuari A.D. se kur mundesh me mi kthye parat, gjithashtu edhe A. e kam dëgjuar duke i thënë ati se ti kthej në muajin shkurt, dhe në atë moment qe A. më ka parë mua në uniformë menjëherë është nda nga i moshuari dhe ka vazhduar në drejtim të rrugës “...” .

Gjykata ka marrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nëpar 1.3 të KPRK-së, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi te pjesa e aktgjykimit lirues, nga se për veprën e parë, i dëmtuar-dëshmitari A.A. në shqyrtimin gjyqësor nuk ka arrit ta identifikoj të akuzuarin, ndërsa për veprën e dytë, i dëmtuari-dëshmitari tani i ndjerë I.(Sh.) E. ka vdekur me datë *data e vdekjes...*, gjë që vërtetohet në bazë të Certifikatës të vdekjes lëshuar nga Komuna e Podujevës zyra e Gjendjes civile me nr. Serik 1.....3 dhe nr. të ref.1./2....RV/1...1 të datës 02.12.2015, për veprën e tretë i dëmtuari dëshmitari tani ndjerë S. (H.) D. ka vdekur 13.05.2015 gjë që vërtetohet nga Certifikata e Vdekjes, lëshuar nga Komuna e Podujevës, zyra e Gjendjes civile me nr. serik V 1.....4 nr. të referencës 1./2...RV/1....3, të lëshuar me datë 02.12.2015, për veprën e katërt i dëmtuari-dëshmitari tani ndjerë, Xh. (Sh.) O. i lindur me datë *data e lindjes...* me nr. personal *numër personal...*, ka vdekur me datë 15.02.2015 gjë që vërtetohet nga vërtetimi mjekësor dhe Informatat e Stacionit Policor të datës 15.12.2015, për veprën e pestë i dëmtuari-dëshmitari Xh. B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk është ky person në sallë ai që më ka mashtruar, dhe për veprën e gjashtë i dëmtuari-dëshmitari tani i ndjerë I. (Z.) S. ka vdekur para një viti, bazuar në Informatën e Stacionit Policor në Podujevë të datës 15.12.2015. Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par 1 dhe 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit, dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme, dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij, dhe bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPRK-së, ku

përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar, në mungesë të provave tjera vendosi me aktgjykim lirues.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor sipas bindjes së lirë vërtetohet gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike vetëm për një veprë penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plot të dëmtuarit Y.E., i cili e ka identifikuar saktësisht të akuzuarin në shqyrtimin gjyqësor që e ka mashtruar duke ja marrë të hollat.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mashtrimi nga neni 261 par. 1 të KPK-së.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kryer veprat penale me dashje, me paramendim, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti nga evidenca e të kaluarës kriminale të kësaj gjykate se i njëjti ka qenë i gjykuar dhe i shpallur fajtor edhe më parë për vepra të njëjta penale, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm me shenjën P.nr.271/2004 i cili ka marrë formën e prerë 01.12.2004 dhe P.nr.1155/2011, i cili ka marrë formën e prerë me datë 22.02.2013, si rrethanë tjetër rënduese gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale duke shfrytëzuar moshën e të dëmtuarit, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në bazë të nenit 73 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 dhe nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e të dëmtuarit Y. E. dhe udhëzimin e të dëmtuarve A.P. dhe Xh. B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363, 364, 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr.106/2011 të dt. 21.01.2016**

**Sekretare juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.